



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 36 datë 2.7.2021

**“PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR. 11, DT. 09.04.2016 ‘PËR MIRATIMIN E DISA LINJAVE TË RREGULLTA RRETHQYTETËSE TË TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE”**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 2.7.2021, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të neni 23 pika 6, neni 54 germa ‘k’ të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligji nr.8378, datë 22.7.1998 ‘Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë’ të ndryshuar; neni 15, 19 i ligjit nr.8308 datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” të ndryshuar ; Udhëzimin nr.5627, datë 18.11.2016 “Për përcaktimin e kritereve rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit” të ndryshuar ; relacionit të administratës së bashkisë Shkodër

**V E N D O S I :**

1.Miratimin e ndryshimit të VKB nr.11, datë 09.04.2016 ‘Për miratimin e disa linjave të rregullta rrethqytetëse të transportit të udhëtarëve’ pika 3 , konkretisht

***ishte :***

Miratimin e linjës së rregullt të transportit të udhëtarëve Shkodër- Shalë –Shkodër me 2 orare. Stacionet për këtë linjë të jenë në : qytet Shkodër tek sheshi pranë spitaleve (ish parku) dhe ne Breg Lumit në njësinë administrative Shalë (sipas planimetrisë).

***bëhet :***

miratimin e linjës së rregullt rrethqytetëse të transportit të udhëtarëve Shkodër-Shalë me dy drejtime lëvizje:

Miratimin e linjës së rregullt rrethqytetëse të transportit të udhëtarëve Shkodër-Shalë me dy drejtime lëvizje:

- a. Shkodër – BregLumi, Shalë – Theth-Shkodër
- b. Shkodër – Koplik – Theth - BregLumi, Shalë – Shkodër.

Stacioni i nisjes dhe mbërritjes për këtë linjë do të jetë në qytetin Shkodër tek sheshi pranë spitaleve, pranë ish Parkut të Udhëtarëve, me 2 orare për sejcilin drejtim lëvizje si më poshtë:

Nisja ora 08.00-09.00 dhe 10.00-11.00

Kthimi 15.00-16.00 dhe 16.00-17.00

(sipas planimetrisë bashkëngjitur)

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

**KRYETAR**

  
**Brisela KADIJA**



Sekretari i Këshillit Bashkiak

  
**Denis Lesha**

Miratuar me 29 vota

Vota Pro 29

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 5.7.2021